



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 179, Datë 29.05.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË  
ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA PRODHUESIT EKZISTUES ME  
PËRPARËSI NGA BURIMET FOTOVOLTAIKE DHE EOLIKE PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 10, pika 5, nenit 29, pika 1 dhe nenit 31, pika 2 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”; dhe nenit 19 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 29.05.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 1469 prot., datë 24.05.2023 nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike”,

**Konstatoi se:**

- Më datë 29 Prill 2023 ka hyrë në fuqi ligji nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” i ndryshuar.
- Ligji nr. 24/2023 në pikën 5 të nenit 10 ngarkon ERE-n, me detyrimin për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, e cila duhet të ketë të përcaktuara kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve sipas llojit të teknologjisë së përdorur.
- Mbështetur në pikën 37 të nenit 3 të ligjit nr. 24/2023, “Prodhues ekzistues me përparësi” është një prodhues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues fotovoltaik deri në 2 MW, eolik deri në 3 MW dhe për hidrocentrale me kapacitet të instaluar deri 15 MW.

- Mbështetur në pikën 2 të nenit 31, *Aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe të zbatohen deri në momentin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.*
- Për sa më sipër në zbatim të nenit 29, pika 1 dhe nenit 31, pika 2 të ligjit nr. 24/2023 “*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*”, për sa kohë nuk është miratuar një Metodologji e re për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike do të vazhdojë të përdoret Metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369/2017 në zbatim të ligjit nr. 7/2017, për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli deri në 2 MW dhe era deri në 3 MW për prodhuesit ekzistues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues.
- VKM nr. 369, datë 26.04.2017 “*Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era*”, në pikën 2 të saj, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj Metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së paraqitur në këtë VKM për sa i takon LCOE dhe WACC ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.
- Metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.04.2017 përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur.
- ERE me fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuesve ekzistues me përparësi do t’i drejtohet MIE-s për informacion lidhur me subjektet të cilët që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose janë pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues.
- Ky informacion do të shërbejë për vlerësimin dhe shqyrtimin e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e çmimeve për teknologjitë në fjalë, mbështetur në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike, për vitin 2023.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë të palët e interesit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**